

1 E mërkurë, 15 dhjetor 2021

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Fillon në orën 9.30

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjesi  
6 dhe mirë se keni ardhur të gjithë.

7 Znj. Sekretare ju lutem thërrisni çështjen.

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjesi të nderuar  
9 Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-07, Prokurori i  
10 Specializuar kundër Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

12 Znj. Bolici, ka ndryshim në ekipin tuaj sot?

13 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Jo, nuk kemi ndryshime.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Rees?

15 Z. REES: [Përkthim] Kemi vetëm zoti Halilaj i cili kishte  
16 një takim me mjekun, por ndërkohë gjithë pjesa tjetër e ekipit  
17 është e njëjta.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

19 Zoti Worboys?

20 Z. WORBOYS: [Përkthim] Jo, të nderuar gjykatës. Siç javën  
21 që shkoi. Zoti Carl Buckley na ndjek nga larg.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

23 Mirëmëngjesi zoti Buckley.

24 Z. BUCKLEY: [Përkthim] Mirëmëngjesi të nderuar Gjykatës.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për

1 procesverbal, zoti Haradinaj dhe zoti Gucati janë të pranishëm  
2 në seancë.

3 Ne do të fillojmë me pyetje të tjera plotësuese për dy  
4 dëshmitarë të ZPS.

5 Ndërkohë më datë 10 dhjetor, Trupi Gjykues pranoi  
6 kërkesën e zotit Gucati për t'i bërë pyetje plotësuese  
7 dëshmitarit 4841 dhe 4842 dhe urdhëroj Mbrojtjen e zotit  
8 Gucati që të kufizojë pyetjet e veta për materialet të cilat  
9 janë nxjerrë, në pajtim me vendimin F413, F435.

10 Mbrojtja duhet të jetë e gatshme për të shpjeguar  
11 rëndësinë e linjës së pyetjeve që kanë të bëjnë me materialet.

12 Paneli po ashtu kujton se, për qëllime të sigurisë dhe  
13 mosnxjerrjes së identitetit të dëshmitareve dhe interesave të  
14 drejtësisë, Mbrojtja është udhëzuar që të kryej këto pyetje  
15 plotësuese në seancë private.

16 Trupi Gjykues, në momentin e duhur do të rishikojë  
17 gjithashtu edhe transkriptin dhe do të urdhërojë ri-  
18 klasifikimin, në qoftë se është e rëndësishme.

19 Zoti Rees juve thatë që pyetjet plotësuese nuk do të  
20 marrin më shumë se gjysmë ore.

21 Ndërkohë që, zoti Worboys, kemi marrë parashtrimin tuaj  
22 të protokolluar ku ju thoni që, do të bëni pyetje në qoftë se  
23 ndonjë pyetje e juaja nuk do të jetë bërë nga zoti Rees dhe se  
24 marrja në pyetje prej jush nuk do të zgjasë më shumë se sa 30  
25 minuta.

1 Gjithashtu do të lejojmë pyetje plotësuese nga Prokuroria  
2 në qoftë se përmbushen kushtet përkatëse.

3 Do të fillojmë me zonjën Pumper dhe pastaj do të  
4 vazhdojmë me zotin Jukiç.

5 Zonja Sekretare, ju lutem shoqërojeni zonjën Pumper në  
6 sallën e gjyqit.

7 [Dëshmitarja hyn në sallën e gjyqit]

8 DËSHMITARJA: [Përkthim] Mirëmëngjesi.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjesi  
10 znj. Pumper. Ju lutem uluni.

11 Ju lutem kujtoni që keni bërë deklaratë solemne në fillim  
12 të dëshmisë tuaj dhe kjo ende zbatohet edhe sot lidhur me atë  
13 çfarë do të thoni përpara gjykatës sot.

14 Mbrojtja e Gucatit ka disa pyetje të cilat kanë të bëjnë  
15 me materialet e nxjerra nga Prokuroria, në pajtim me dy  
16 vendimet e Trupit Gjykses.

17 Z. Rees është i pari që do të bëjë pyetje. Më pas  
18 avokatët që përfaqëson z. Haradinaj mund të bëjnë disa pyetje  
19 gjithashtu. Më pas Paneli mund të lejojë Prokurorinë që të  
20 bëjë pyetje plotësuese në qoftë se përmbushen kushtet dhe në  
21 qoftë se kërkohet. Së fundi, edhe anëtarët e Trupit Gjykses  
22 mund t'ju bëjnë ju disa pyetje.

23 Ju kërkohet që të flisni afër mikrofonit. Ju lutem bëni një  
24 pauzë të shkurtër para se të jepni përgjigjen, në mënyrë që  
25 t'i jepni kohë përkthyesve që t'ju ndjekin.

1 Për qëllime të sigurisë dhe për interes të drejtësisë dhe  
2 për çështje sigurie, ne do ta realizojmë këtë seancë gjyqësorë  
3 në seancë private.

4 Znj. Sekretare, a mund të kalojmë në seancë private, ju  
5 lutem.

6 [Seancë private]

7 [Seancë private teksti i fshirë]

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitarja: Zdenka Pumper (Rithirrur) (Seancë private)  
Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Worboys

Faqe 5

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Zdenka Pumper (Rithirrur) (Seancë private)  
Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Worboys

Faqe 6

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Zdenka Pumper (Rithirrur) (Seancë private)  
Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Worboys

Faqe 7

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25



1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9 [Seancë e hapur]

10 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
11 jemi tani në seancë publike.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

13 [Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjesi  
15 z. Jukiç. Ju lutem uluni.

16 DËSHMITARI: Faleminderit i nderuar Gjykatës.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,  
18 mbani mend që keni bërë një deklaratë solemne në fillim të  
19 dëshmisë suaj dhe kjo është ende e vlefshme lidhur me atë  
20 çfarë do thoni në gjykatë, sot.

21 Mbrojtja e z. Gucati ka disa pyetje të tjera për ju  
22 lidhur me materialet e nxjerra nga ZPS-ja, në pajtim me dy  
23 vendimet e Trupit Gjykues. Z. Rees do të jetë i pari. Më pas  
24 avokatët që përfaqësojnë z. Haradinaj mund të kenë disa pyetje  
25 për ju. Dhe Trupi Gjykues do të lejojë pyetje plotësuese nga

1 Prokuroria, në qoftë se kërkohet nga ana e Prokurorisë dhe në  
2 qoftë se përmbushen kushtet. Në fund, anëtarët e Trupit  
3 Gjykues mund të kenë disa pyetje për juve.

4 Ju lutem flisni përpara mikrofonit, bëni një pauzë prej  
5 5 sekondash përpara se sa të jepni përgjigjen, në mënyrë që të  
6 mund të ndjekin përkthyesit.

7 Për arsye të sigurisë, mos nxjerrjes së identitetit të  
8 dëshmitarëve dhe interesave të drejtësisë, mbrojtja do t'i bëj  
9 pyetjet e saj, në seancë private.

10 Znj. Sekretare, ju lutem a mund të kalojmë në seancë  
11 private.

12 [Seancë private]

13 [Seancë private teksti i fshirë]

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Miro Jukic (Rithirrur) (Seancë private)  
Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Worboys

Faqe 12

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25



1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9 [Seancë e hapur]

10 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Jukiç, me  
12 kaq përfundon dëshmia juaj. Ju mund të largoheni nga salla e  
13 gjyqit. Ju urojmë ditë të mbarë. Ju faleminderit që ishit këtu  
14 me ne.

15 Zonja ndihmëse, mund ta përcillni z. Jukiç jashtë sallës.

16 DËSHMITARI: Faleminderit i nderuar Gjykatës.

17 [Dëshmitari largohet nga salla e gjyqit]

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të

19 vazhdojmë.

20 Z. Rees, Trupi Gjykses është informuar se keni tërhequr  
21 dëshmitarin 1247. Kishit mundësinë t'i bënit pyetje plotësuese  
22 dy dëshmitarëve të ZPS. A keni ndonjë dëshmi tjetër për të  
23 thirrur?

24 Z. REES: [Përkthim] Me përjashtim nëse z. Pace don të  
25 japë dëshmi gojore, atëherë unë vetë nuk pres që të thërras

1 dëshmitarë të tjerë në çështjen e mbrojtjes.

2 Ka një mocion për pranimin e provave jo gojore, që për të  
3 cilën nuk është marrë vendim. Ka një dokument që e kam harruar  
4 si me dëshminë e vetë z. Gucati, ashtu edhe në përpilimin e  
5 atij mocioni. Është dokumenti DHG0496.

6 Kam biseduar me Prokuroren znj. Bolici dhe Prokuroria nuk  
7 kundërshton pranimin apo përfshirjen e këtij dokumenti në  
8 mocionin për pranimin e dokumenteve jогоjore. Është një  
9 dokument i shkurtër. Është një postim i z. Gucati në Facebook.

10 Është dokument që mban datën 15 shtator 2020. Ndoshta i  
11 kujtohet Trupit Gjykues se i kam bërë znj. Pumper pyetje në  
12 lidhje me atë postim. Thuhet se rëndësia e këtij dokumenti  
13 është se shkon në mbështetje të asaj që ka thënë z. Gucati  
14 edhe gjatë dëshmisë së drejtpërdrejtë edhe në deklaratën e tij  
15 të pranuar sipas rregullës 154. Është dokument pas dorëzimit  
16 të Paketës së dytë, pra Vetëtima 2.

17 E shfrytëzoj rastin që të falënderoj ZPS për  
18 bashkëpunimin e tyre.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.  
20 Urdhëroni znj. Bolici.

21 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Ne nuk kundërshtojmë që ky  
22 dokument t'i shtohet listës, mirëpo do të kundërshtojmë  
23 pranimin e këtij dokumenti.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit  
25 znj. Bolici.

1 Z. Rees, edhe diçka tjetër për të shtuar?

2 Z. REES: [Përkthim] Lidhur me mocionin për pranimin e  
3 provave jогоjore. Përpara se ta shpallim zyrtarisht të mbyllur  
4 çështjen e Mbrojtjes, duam që të marrim njëherë vendimin e  
5 Trupit Gjykues mbi atë mocion dhe do të kërkojmë nga Trupi  
6 Gjykues që të na japë udhëzime në lidhje me dorëzimin e një  
7 njoftimi zyrtar, pasi ta kemi marrë vendimin për këtë mocion.

8 Është thjesht një kujdes nga ana jonë që na lë mundësinë  
9 t'i bëjmë një kërkesë Trupit Gjykues në lidhje me ndonjë  
10 aspekt të atij mocioni.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kemi ndërmend  
12 që vendimin për mocionin për pranimin e provave jогоjore, ta  
13 marrim në fund të kësaj jave.

14 Z. REES: [Përkthim] Faleminderit.

15 Çështja e dytë ka të bëjë me diskutimet që vazhdojnë në  
16 lidhje me faktet e pranuar nga palët, në lidhje me pika që  
17 nuk janë të kontestueshme. Unë pajtohem se këto fakte dhe  
18 palët mund të pajtohen rreth tyre në të cilëndo fazë të  
19 procedurës, që do të thotë edhe gjatë fazës së paraqitjes të  
20 provave nga Mbrojtja e z. Haradinaj.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit  
22 për këtë informacion.

23 Z. Worboys, sa i përket Mbrojtjes së Haradinaj, ajo nuk  
24 ka paraqitur mocion për pranimin e provave jогоjore më vete,  
25 brenda afatit 10 dhjetor. Sikurse u theksua, Mbrojtja e

1 Haradinajt iu bashkua mocionit të Gucatit për pranimin e  
2 provave jогоjore.

3 Z. Worboys ose z. Buckley kush do të flasë, ne e kuptojmë  
4 këtë si diçka se Mbrojtja e Haradinajt nuk do të paraqesë  
5 mocion më vete për pranimin e provave jогоjore.

6 Z. WORBOYS: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, keni të  
7 drejtë. Ne i jemi bashkuar mocionit të Gucatit për pranimin e  
8 provave jогоjore.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjithashtu,  
10 theksoj se Mbrojtja e Haradinajt ka dorëzuar dy lista të  
11 provave. Të parën më 2 dhjetor 2021, pas zgjatjes së afatit  
12 fillestar që ishte 29 nëntor. Ky është dokumenti me numër  
13 F469.

14 Lista e dytë është dorëzuar më 10 dhjetor 2021, në vijim  
15 të urdhrit të ripërtërirë për përditësimin e listës së provave  
16 në përputhje me urdhrin për kryerjen e procedurave. Ky është  
17 dorëzimi F489.

18 Tani kemi dy lista pothuajse plotësisht të ndryshme. E  
19 para ka 30 prova dhe aty nuk shënohet se cila provë do të  
20 paraqitet me cilin dëshmitar. Dhe kjo listë është pothuajse e  
21 njëjtë me listën e provave të Gucatit, me përjashtim të tre  
22 dokumenteve të fundit.

23 Lista e dytë ka 23 prova dhe 21 prej tyre nuk paraqiten  
24 në listën e parë. Për çdo provë në këtë listë të dytë, ju  
25 tregoni edhe emrin e dëshmitarit nëpërmjet të cilit do ta

1 paraqisni atë si provë. Keni kërkuar që këto prova t'i shtohen  
2 listës së dytë [sipas përkthimit].

3 Përpara se t'ju bëj pyetje për këto lista, ju përkujtoj  
4 se si funksionon kjo. Në rregullën 119(2)(b) thuhet se,  
5 Mbrojtja duhet të dorëzojë një listë të provave të propozuara  
6 që synon t'i paraqesë. Që do të thotë që, ju synoni t'i  
7 përdorni në paraqitjen e provave ose t'i paraqitni për pranim.

8 Sipas paragrafit 60 dhe 61 të urdhrin tonë për kryerjen e  
9 procedurave, ne kemi kërkuar nga palët që të tregojnë se me  
10 cilët dëshmitarë do t'i paraqesin provat përkatëse.

11 Qëllimi i kësaj është që të shmangim çdo mbingarkim të  
12 listës së provave, me prova materiale që palët nuk kanë  
13 ndërmend t'i përdorin gjatë paraqitjes së çështjes së tyre.

14 Tani, a mund, ju lutem, të na shpjegoni se cili është  
15 roli i këtyre dy listave të ndryshme?

16 Z. WORBOYS: [Përkthim] Fillimisht dua të them që, në  
17 qoftë se është bërë ndonjë gabim apo ngatërresë, është  
18 rezultat i vendimeve të mia në lidhje me këtë.

19 Lista e parë, me sa kuptoj unë, duhet të zëvendësohet në  
20 bazë të urdhrin të Gjykatës dhe lista e dytë në fakt, është  
21 ajo që e zëvendëson të parën.

22 Për ta shpjeguar atë se çfarë janë dokumentet shtesë,  
23 sipas mendimit tim, në lidhje me dëshmitarin 1252, do të ketë  
24 dëshmi të drejtpërdrejtë gojore. Ka shumë dokumente që  
25 përmenden që janë burime ligjore, mirëpo për nga aspekti



1 teknik janë thjesht raporte ekspertësh. Këto dokumente janë  
2 shtuar në listën tonë sipas rregullës 119(2) (b), në mënyrë që  
3 ato të paraqiten si prova dhe Gjykata t'i ketë në dispozicion.

4 Në qoftë se ka ndonjë proces më efikas për parashtrimin e  
5 këtyre dokumenteve, ne kërkojmë udhëzime nga Trupi Gjykses. Ne  
6 këto dokumente nuk i kemi pasur në dosje dhe nuk ka pas as  
7 ZPS-ja mundësinë që t'i shikojë ato paraprakisht për t'i  
8 shqyrtuar ato dhe për të parë se për çfarë bëhet fjalë.

9 Kur të mbërrijmë tek dëshmitari 1252, besoj që do të  
10 merremi vesh dhe mund ta trajtojmë çështjen e atyre  
11 dokumenteve në mënyrë efikase.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] D.m.th. ju  
13 thoni që lista e dytë e zëvendëson plotësisht listën e parë  
14 dhe mund që këtë listën e parë, të mos ta marrim më fare  
15 parasysh?

16 Z. WORBOYS: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës. Ju mund  
17 padyshim të mbështeteni në dokumentet që janë paraqitur  
18 nëpërmjet listës së provave të Gucatit.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.  
20 Prokurore ose kushdo nga Prokuroria që do të përgjigjet. A  
21 keni kundërshtim në lidhje me shtimin e provave të reja në  
22 listën e Haradinajt të provave, sipas rregullës 119(2).

23 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime, por do të  
24 kërkojmë qartësi për sa i përket se cilat prova duhet të  
25 përdoren me cilët dëshmitar, në mënyrë që të lehtësohet

1 kryerja e procedurës.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A mund ta  
3 bëjmë këtë tash menjëherë?

4 Z. WORBOYS: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, dokumentet e  
5 përfshira në listën e re, janë në lidhje me 1252. Ato që  
6 përmenden në raport duhen të jenë të kuptueshme qartësisht nga  
7 vetë raporti.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj. Bolici  
9 thotë që nuk kundërshtojnë parashtrimin e listës, me kusht që  
10 të qartësoni se cilat prova do të paraqiten, me cilët  
11 dëshmitarë.

12 Z. WORBOYS: [Përkthim] Padyshim që do ta bëjmë këtë.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjeni këtë  
14 gjatë ditës së sotme.

15 Duke qenë se Prokuroria nuk kundërshton shtimin e provave  
16 të reja në listën e provave të mbrojtjes së Haradinajt, pra  
17 dokumentin F489 shtojca 1, Paneli autorizon, lejon përfshirjen  
18 e këtyre provave në përputhje me rregullën 119(5). Ju lutem që  
19 të na e bëni të ditur ju si palë, në qoftë se mbetet ndonjë  
20 aspekt i pazgjidhur.

21 Mbrojtja e Haradinajt urdhërohet që të dorëzojë një listë  
22 të konsoliduar të provave deri më 6 janar 2020 [sipas  
23 përkthimit], që do të përfshijë të gjitha provat që ka  
24 ndërmend t'i përdorë dhe dëshmitarët nëpërmjet të cilëve do  
25 t'i paraqesë ato prova. Me kaq përfundon urdhri gojor.

1 Edhe një çështje që lidhet me administrimin e  
2 dokumentacionit.

3 Më 23 nëntor, ZPS-ja parashtroi redaktimet e propozuara  
4 publike lidhur me një numër provash materiale të pranuar.  
5 Është parashtrimi numër F445. Asnjë ekip i Mbrojtjes nuk  
6 dorëzoi përgjigje ndaj këtij parashtrimi.

7 Të hënën më 13 dhjetor 2021, ZPS-ja dorëzoi versionin e  
8 ndryshuar të redaktimeve të propozuara publike të një nga  
9 provave materiale. Trupi Gjykues do të marrë vendim lidhur me  
10 këtë kërkesë deri të premtën e kësaj jave. A ka Mbrojtja  
11 ndonjë kundërshtim lidhur me versionin e ndryshuar të  
12 propozuar që ZPS-ja dorëzoi të hënën?

13 Z. Rees?

14 Z. REES: [Përkthim] Mendoj që nuk kemi. Por mund të na  
15 jepni pak kohë, në mënyrë që ta shqyrtojmë këtë dhe pastaj  
16 mund të konfirmojmë qoftë gojarisht, qoftë me shkrim?

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sot?

18 Z. REES: [Përkthim] Po.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë ta  
20 lëmë deri në orën 16.00 të dorëzohet dokumenti përkatës. Z.  
21 Worboys?

22 Z. WORBOYS: [Përkthim] I njëjti qëndrim.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë, deri  
24 në orën 16.00 sot do të presim t'i dorëzoni parashtrimet tuaja  
25 me shkrim, në lidhje me këtë provë.

1 Tani do të trajtojmë kërkesën e Haradinajt për shtyrje të  
2 seancave gjyqësore. Më 12 dhjetor, Mbrojtja e Haradinajt i  
3 dërgoi Trupit Gjykses një email ku kërkoi shtyrjen e fillimit  
4 të paraqitjes së provave deri në vitin e ri.

5 Më 13 nëntor, pas udhëzimeve të Trupit Gjykses, Mbrojtja  
6 e Haradinajt parashtroi zyrtarisht një kërkesë, ku kërkoi  
7 shtyrjen e gjykimit deri në janar 2022 dhe zgjatjen e afatit  
8 për dorëzimin e deklaratës së dëshmitarit z. Haradinaj.

9 Parashtrimi i Haradinajt, mban numrin F491.

10 Po atë ditë, Trupi Gjykses nxori një urdhër me të cilin  
11 informoi Mbrojtjen e Haradinajt dhe zyrën administrative se  
12 dëshmitarët e Mbrojtjes 1246 dhe 1254, nuk priten më që të  
13 paraqiten këtë javë. Trupi Gjykses gjithashtu informoi palët  
14 se do dëgjojë parashtrimet e mëtejshme nëse do të ketë, lidhur  
15 me kërkesën e Mbrojtjes së Haradinajt sot.

16 Z. Worboys ose Z. Buckley e keni fjalën. Ju lutem bëni të  
17 ditur nëse jeni të gatshëm të bëni deklaratën hyrëse sot ose  
18 nesër.

19 Z. WORBOYS: [Përkthim] I nderur Gjykatës, tani nuk do  
20 përsëris atë që është thënë në kërkesën e shtyrjes së seancës  
21 dhe në emailin që është dërguar. Atë që do të them tani është  
22 se, ky parashtrim u bë në mënyrë të hapur dhe transparente dhe  
23 unë aty paraqita vlerësimet e miya se çfarë ishte e mundur dhe  
24 çfarë s'ishte e mundur në kryerjen e detyrave të mia  
25 profesionale.

1           Çfarë mund t'ju përditësoj sot është se, jemi në gjendje  
2 të bëjmë deklaratën hyrëse sot, që sado pak do të shënojë një  
3 farë progresi në çështjen. Kam biseduar me ZPS-në lidhur me  
4 këtë, ata nuk kundërshtojnë që deklarata hyrëse të bëhet sot.

5           Përveç kësaj, për nevojat e administrimit të çështjes  
6 gjyqësore, kam biseduar me ZPS-në, ju kam përgatitur një kohë  
7 të përafërt se sa do të na duhet me çdo dëshmitar që do ta  
8 thërrasim. Mund t'ua jap këtë edhe sot në qoftë se doni.

9           KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, mund ta  
10 bëni këtë.

11           Z. WORBOYS: [Përkthim] Jam [sipas përkthimit] konsultuar  
12 edhe me Mbrojtjen e Gucatit edhe ZPS-ja mund të paraqesë çdo  
13 kundërshtim nëse ka lidhje me radhitjen që propozojmë ne. Për  
14 z. Haradinaj ne llogarisim që do të na duhet gjysmë dite  
15 dhënie dëshmie. Do të kërkojmë që deklarata e tij me shkrim të  
16 paraqitet si provë, sipas rregullit 154.

17           ZPS-ja llogarit se do t'i duhen rreth 10 orë, që do të  
18 thotë rreth 3 ditë pune.

19           Për dëshmitarin 1246, 15 minuta mendoj që do të jenë të  
20 nevojshme dhe dy orë për pyetje të palës kundërshtare.

21           Në lidhje me z. Gashi, mendojmë se në mënyrë të ngjashme  
22 do të na duhen 15 minuta për leximin e deklaratës dhe 4 orë  
23 për kundërpjetjet.

24           Për dëshmitarin 1252, mendoj se do të jenë 2 orë të  
25 mjaftueshme për sa i përket pyetjeve tona. Kurse ZPS-ja ka

1 bërë të ditur se mund t'i duhen rreth 2 orë për kundër pyetjet  
2 e saj. Dhe nëse i marrim të gjitha këto bashkërisht, ka një  
3 farë shprese që me këta dëshmitarë të përfundojmë brenda 4-5  
4 ditësh, katër ditë e gjysmë pune në vitin e ri.

5 Një aspekt i kërkesës që ju e keni parë, të nderuar  
6 Gjykatës, ka të bëjë me parashtrimin e deklaratës së z.  
7 Haradinaj.

8 Në lidhje me këtë, realiteti, pa nxjerrë shumë  
9 informacion, është se ka disa vështirësi logjistike dhe  
10 praktike. Unë nuk jam aq i njoftuar me mënyrën si funksionon  
11 sistemi dhe nga ana tjetër është edhe nevoja që të sigurojmë  
12 se çdo gjë që ka nënshkruar z. Haradinaj, është e saktë dhe  
13 është dëshmi e tij.

14 Nuk dua që t'i jap premtime të rrejshme Gjykatës, por në  
15 interes të të qenit i kujdesshëm, mund t'ju them se mund ta  
16 dorëzojmë për protokollim deklaratën e nënshkruar te z.  
17 Haradinaj deri në orën 16.00 mbas dite, më datën 22 janar  
18 [sipas përkthimit], pra mbas një jave.

19 Kjo datë për mendimin tonë, nuk i shkakton ndonjë  
20 padrejtësi thelbësore ZPS apo procesit dhe zhvillimit të  
21 procedurave në këtë pikë kohore. Mendoj që, me gjithë  
22 sinqeritetin tim, se kjo është më e mira që ne mund të ofrojmë  
23 në këtë moment.

24 Z. REES: [Përkthim] Në qoftë se ju ndihmojmë, ne do t'ju  
25 japim edhe kohën që do të na duhet ne për pyetjet e

1 dëshmitarëve të Mbrojtjes së z. Haradinaj. Këto kohë që do  
2 t'ju japim, janë me një kusht.

3 Mendoj që në këtë orar të lihet vend, të paktën për një  
4 orë, në lidhje me z. Haradinaj për dëshmitarin 1246, një orë  
5 për z. Gashi dhe një orë për dëshmitarin 1252.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju  
7 faleminderit z. Rees. Besoj që nuk keni ndonjë kundërshtim në  
8 lidhje me kërkesën e z. Haradinaj për shtyrjen e seancës  
9 gjyqësore.

10 Znj. Bolici, ju?

11 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Dua së pari të theksoj se na vjen  
12 keq për gjendjen shëndetësore të z. Cadman dhe mirëpresim  
13 kthimin e tij në sallën e gjyqit.

14 Lidhur me kërkesën për shtyrjen e seancës, duhet që të  
15 kemi parasysh efikasitetin e procedurave, sikurse theksohet në  
16 vendimin kuadër dhe në legjislacionin në fuqi.

17 Nuk janë të justifikueshme shtyrjet e procedurave kur  
18 kemi dy bashkëmbrojtës, të cilët mund të sigurojnë vazhdimin e  
19 përfaqësimit të të akuzuarit në kohën kur mbrojtësi kryesor  
20 nuk është i disponueshëm.

21 Udhëzuesi i Punës i zyrës administrative, në nenin 18,  
22 paragrafi 2 dhe 4, thotë se: "Kur përzgjedh anëtarët e ekipit  
23 të vet, Mbrojtësi duhet të marrë parasysh përvojën e tyre dhe  
24 kompetencat e tyre si bashkëmbrojtës dhe bashkëmbrojtësit e  
25 zgjedhur kanë autoritetin që të nënshkruajnë dokumente dhe të

1 paraqiten në gjyq në emër të Mbrojtësit kryesor, kur ngrihen  
2 çështje juridike”.

3 Gjithashtu, në kërkesë nuk përmendet fakti që ka qenë i  
4 përfshirë, që është i përfshirë edhe bashkëmbrojtësi i dytë që  
5 nga fillimi i çështjes, pra në paraqitjen e kësaj çështje  
6 gjyqësore.

7 Së fundi, ne nuk shohim ndonjë arsye për vështirësitë e  
8 komunikimit midis Mbrojtjes dhe z. Haradinaj.

9 Kemi parasysh organizimin që është bërë në lidhje me dy  
10 dëshmitarët e ardhshëm të z. Haradinaj, të cilët janë anuluar.

11 Për sa i përket kërkesës për një shtyrje të tretë në  
12 lidhje me njoftimin e z. Haradinaj, duam të theksojmë se  
13 Mbrojtja ka qenë në dijeni të detyrimit për paraqitjen e këtij  
14 njoftimi që nga fillimi i procedurave dhe se në urdhrin për  
15 caktimin e datës 9 nëntor thuhej, përmendej afati i 29  
16 nëntorit për nxjerrjen e deklaratave të tyre, nëse do të  
17 kishte dhe afati për nxjerrjen e deklaratave, tashmë dy herë  
18 është shkelur.

19 Ne e kemi të qartë se nuk ka ndonjë pengesë që z.  
20 Haradinaj të nënshkruajë deklaratën me shkrim. Nuk i shkakton  
21 padrejtësi ZPS-së që ta marrë këtë deklaratë në një datë më të  
22 vonshme. Në fakt, tashmë i është shkaktuar padrejtësi ZPS-së  
23 me shtyrjen e kundër pyetjeve.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit  
25 znj. Bolici.



1 A ka ndonjë pyetje nga Paneli?

2 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Kam një koment në vend të  
3 një pyetjeje.

4 Së pari dua të them që, në kundërshtim me atë që u tha në  
5 kërkesën për shtyrje, nuk kam përshtypjen se z. Worboys ka  
6 nevojë për më shumë informacion.

7 Në rast se unë gabohem, atëherë do të thosha z. Buckley,  
8 që Trupi Gjykses pret nga ju, dhe nëse është e mundur nga z.  
9 Cadman, që të njoftojë menjëherë kolegun tuaj z. Worboys  
10 përpara seancës tjetër. Shpresoj që kjo të jetë e qartë, z.  
11 Buckley.

12 Z. BUCKLEY: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Po, neve  
13 jemi në kontakt të vazhdueshëm me z. Worboys, nuk kemi asnjë  
14 problem. Nuk është se nuk duam apo ngurojmë të japim dëshmi,  
15 apo të komunikojmë me njëri-tjetrin në çdo rast.

16 Qëndrimi që kemi ne, për fat të keq, është një qëndrim  
17 krejtësisht unik sepse siç e dini, tani jemi në pandemi, ka dy  
18 vjet që kemi dhe kjo ka ndikuar shumë në punën tonë.  
19 Megjithatë, gjatë javëve të fundit kjo situatë është  
20 përkeqësuar, sidomos në rastin e ekipit të Mbrojtjes dhe në  
21 përgjithësi në të gjithë Evropën.

22 Por dua të rikonfirmoj se nuk kemi asnjë problem me  
23 komunikimin midis nesh.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] E kuptoj, faleminderit  
25 shumë.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi  
2 Mettraux ka një pyetje.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pyetja është për ju, z.  
4 Worboys. Dhe ju lutem mos e merrni si kritikë. Ju e keni  
5 ndihmuar shumë Trupin Gjygues dhe ju jemi mirënjohës.

6 Por dua t'ju pyes se, çfarë konkretisht ju pengon që ta  
7 finalizoni, ta përfundoni deklaratën e z. Haradinaj. Ne jemi  
8 njoftuar më 3 shtator të këtij viti se z. Haradinaj synonte të  
9 dëshmonte në atë kohë, që unë mendoj se duhet të kishte  
10 filluar puna për përgatitjen e deklaratës dhe atëherë nuk  
11 ishte problem lidhur me qasjen tek z. Haradinaj nga ana e z.  
12 Cadman.

13 Pra thjeshtë dua ta kuptoj nga ju se çfarë po i pengon  
14 gjërat, është çështja e firmës. Pra Prokuroria ka të drejtë  
15 kur thotë që, duhet sa më shpejt të marri një kopje të  
16 deklaratës për t'u përgatitur si duhet.

17 A mund të na ndihmoni për këtë?

18 Z. WORBOYS: [Përkthim] Po, e kemi marrë shënim atë që ju  
19 thatë dhe do të bëjmë çmos t'i përgjigjemi.

20 Puna nuk është që të justifikohemi, të them që unë s'kam  
21 qenë përfshirë dhe nuk komentoj, sepse s'kam qenë. Nuk  
22 komentoj dot në hollësi të mëdha.

23 Për sa i takon ku jemi tani, realiteti është që gjatë  
24 fundjavës u përpoqa që të kontaktoj z. Haradinaj mbas seancës  
25 së të premtës, ku u tha se z. Cadman është përkeqësuar nga ana

1 shëndetësore. Por përpjekjet e mia dolën pa sukses, sepse tani  
2 e kuptoj që nuk lejohet të flasësh me dëshmitarët gjatë  
3 fundjavës, minutën e fundit, kështu që kaluan disa ditë.

4 Pati një përditësim të gjendjes që ju dërgua z.  
5 Haradinaj, me qëllimin që të kalohej nesër. Por për shkak të  
6 procesit që ndjek njësia e paraburgimit, nuk i arriti atij  
7 dje. Unë sigurisht bëj çmos që të marr udhëzime kur nuk kam  
8 deklaratë, por nuk mund të bëj gjë pa ia dërguar deklaratën z.  
9 Haradinaj.

10 Unë propozoj që të takohem përsëri me të sot mbas dite,  
11 po qe se është e mundur, ose nesër, me idenë që të shtypet  
12 deklarata e tij dhe t'i jepet një kopje. Por mund të ketë  
13 nevojë edhe për ndonjë ndryshim dhe për shkak të gjuhëve të  
14 ndryshme, vonohet pak edhe nga përkthimi. Në qoftë se  
15 s'arrihet të bëhet të premtën, përsëri humbasim dy ditë.

16 Pra, është problem logjistik, për mendimin tonë dhe unë  
17 megjithatë e kam parasysh detyrimin tim profesional që,  
18 gjithçka të kuptohet përpara se sa të nënshkruhet. Është një  
19 detyrim që unë e marr seriozisht, nuk dua ta bëj punën shkel e  
20 shko, ta lë për minutën e fundit, thjesht se do të ikin dy  
21 ditë më shumë.

22 Unë do të bëj çmos që ta zgjidh këtë problem sa më shpejt  
23 që të jetë e mundur, por data 22 siç u kërkua, nuk arrij dot.

24 Siç u tha, ka dy afate që nuk u respektuan. Unë i thashë  
25 Gjykatës që do të përpiqem ta bëj këtë të mërkurën, ashtu i

1 thashë. Por në atë kohë u përkeqësua shumë shëndeti i z.  
2 Cadman dhe pastaj dolën këto probleme që unë nuk i dija  
3 përpara, nuk i kisha menduar. E kam parasysh që nuk është një  
4 situatë e mirë për askënd dhe siç thashë, i kam parasysh  
5 detyrimet e mia si bashkëavokat, por mbi të gjitha kam detyrim  
6 ndaj klientit për të bërë punën time.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, z. Worboys.

8 [Anëtarët e Trupit Gjykues këshillohen]

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.  
10 Këtu përfundojnë të gjitha pyetjet që kishim për sot. Do të  
11 bëjmë një pushim për më shumë se një orë dhe do të kthehemi  
12 këtu, do të nxjerrim një urdhër dhe përgatituni të bëni  
13 deklaratën hapëse.

14 Ju është dhënë përkthyesve një kopje?

15 Z. WORBOYS: [Përkthim] Po, ju është dhënë. Është dërguar  
16 mbrëmë.

17 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Lidhur me vlerësimin për pyetjet  
18 që do të bëjë Prokuroria, dua t'ju vë në dukje se, në rastin e  
19 1253 [sipas përkthimit] duke pasur parasysh materialet që janë  
20 nxjerrë, do ta rikonsiderojmë kohën e pyetjeve tona, që të mos  
21 marrim shumë kohë.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit  
23 znj. Bolici.

24 Shpresojmë që t'i kaloni z. Cadman urimet tona që të  
25 shërohet sa më shpejt. Na vjen keq, e kemi parasysh gjendjen e

1 tij.

2 Një gjë të fundit...

3 Në parashtrimin apo emailin që morëm javës që shkoi  
4 lidhur me shtyrjen, u bë një deklaratë se, Trupi Gjykues ishte  
5 nën trysni. Dua ta bëj të qartë se e vetmja trysni që ne  
6 ndjejmë është ajo që vetë-imponohet. Askush nuk e detyron dot  
7 Trupin Gjykues të bëj gjë tjetër veçse një gjykim të drejtë  
8 dhe të shpejtë. Dhe ne kemi bërë maksimumin dhe do të  
9 vazhdojmë ta bëjmë.

10 Do të kthehem mbas 1 ore dhe 20 minutash dhe do të  
11 përfundojmë me urdhrat dhe pastaj do të mirëpresim deklaratën  
12 hapëse të z. Worboys. Faleminderit.

13 --- Pauza fillon në orën 10.38

14 --- Seanca rifillon në orën 12.00

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani Trupi  
16 Gjykues do të nxjerrë një urdhër me gojë lidhur me kërkesën e  
17 Mbrojtjes së Haradinaj për shtyrjen e seancës gjyqësore deri  
18 në vitin 2022.

19 Ka katër çështje [sipas përkthimit], që duhen trajtuar:  
20 roli dhe përgjegjësia e Mbrojtjes, përgjegjësia e Trupit  
21 Gjykues, deklarata hapëse, deklarata e z. Haradinaj dhe  
22 paraqitja e provave nga Mbrojtja e Haradinajt.

23 Fillimisht lidhur me përgjegjësinë e mbrojtësit.

24 Trupi Gjykues dëshiron ta bëjë të qartë se mosprania e  
25 mbrojtësit kryesor në sallën e gjyqit apo pamundësia e tij për

1 të kryer funksionet e tij për shkaqe shëndetësore dhe të  
2 tjera, në vetvete nuk përlligj shtyrjen e gjykimit sipas  
3 rregullit 123. Në këtë drejtim Trupi Gjykues tërheq vëmendjen  
4 ndaj seksionit 18(4) të Direktivës për Gjykatësit sipas të  
5 cilit "Bashkëgjyqësi ka të drejtë të nënshkruajë deklarata,  
6 dokumente dhe të paraqitet në gjyq".

7 Ka dy avokatë mbrojtës që kanë kompetencë të plotë për të  
8 përfaqësuar të akuzuarin dhe për të vepruar në emër të tij dhe  
9 sipas udhëzimeve të tij. Njëri është fizikisht i pranishëm dhe  
10 tani ka bërë maksimumin e tij për t'i çuar përpara këto  
11 procedura. Tjetri merr pjesë nga larg dhe siç u tha më herët  
12 është në kontakt të vazhdueshëm me z. Worboys. Prandaj Trupi  
13 Gjykues thekson se organizimi dhe ndarja e detyrave që është  
14 bërë në bazë të marrëveshjes midis avokatëve në asnjë mënyrë  
15 nuk cilësojnë detyrimet e mbrojtësve ndaj klientit të tyre apo  
16 ndaj Trupit Gjykues.

17 Së dyti, përgjegjësia e Trupit Gjykues.

18 Siç thashë më herët ky Trup Gjykues përgjigjet për  
19 kryerjen e shpejtë, të drejtë të procedurave siç parashikohet  
20 ne nenin 40 të Rregullores dhe rregullin 116. Trupi Gjykues ka  
21 parasysh që të akuzuarit janë në paraburgim dhe çdo vonesë  
22 mund të ndikojë në ecurinë e drejtë të këtij gjykimi. Prandaj  
23 Trupi Gjykues ka detyrimin që t'i çojë përpara punimet dhe  
24 vetëm në raste të veçanta kur ka arsye të fortë t'i shtyjë.

25 Trupi Gjykues pastaj do që të dëgjojë nga Mbrojtja e

1 Haradinajt deklaraten hapëse prandaj e drejton këtë Mbrojtje  
2 që të hapë çështjen sot në datën 15 dhjetor.

3 Çështja e katërt, kërkesa për shtyrjen e kohës për  
4 parashtrimin e deklaratën të z. Haradinaj.

5 Trupi Gjykses konstaton se dy arsyet e paraqitura  
6 fillimisht nga Mbrojtja se z. Haradinaj ka qenë në karantinë  
7 deri kohët e fundit dhe se anëtarë kyç të ekipit të tij kanë  
8 qenë të munguar për shkak të COVID-it nuk janë bindës.

9 Trupi Gjykses konstaton që në fillim se vendimi i z.  
10 Haradinaj për të dëshmuar është i bërë i njohur para 3 muajsh  
11 shumë më përpara se të dilnin çështjet që kanë të bëjnë me  
12 COVID-in. Prandaj Trupi Gjykses supozon se themeli i punës për  
13 këtë, paraqitjen e këtij dokumenti është bërë dhe se nuk është  
14 bërë kërkesë në atë kohë për shtyrjen e kohës për të  
15 finalizuar këtë dokument.

16 Gjithashtu Trupi Gjykses konstaton se z. Haradinaj ka  
17 qenë i pranishëm në Gjykatë gjatë javës së shkuar dhe ka pasur  
18 rastin të takohet me bashkëmbrojtësin personalisht.

19 Së fundi Trupi Gjykses kujton se z. Haradinaj dhe ekipi i  
20 tij i mbrojtjes kanë pasur mundësinë që të kenë takime  
21 konfidenciale qoftë fizikisht, me telefon apo me Zoom meqenëse  
22 z. Haradinaj është larguar nga karantina në datën 8 dhe se  
23 këto kontakte mund të lehtësohen, mund të mundësohen me  
24 ndihmën e Njësisë së Menaxhimit të Çështjes.

25 Në këtë rast, Trupi Gjykses paraqet, pranon parashtrimin

1 e z. Worboys lidhur me vështirësitë për kontaktet e tij me z.  
2 Haradinaj, prandaj po i japim një shtyrje të fundit fare për  
3 parashtrimin e deklaratës së z. Haradinaj.

4 Gjithashtu Trupi Gjykses konstaton parashtrimet e ZPS-së  
5 që kjo gjë mund t'i shkaktojë dëme asaj në përgatitjen e  
6 çështjes me qëllim që të mos kërkohen më shtyrje të tjera,  
7 prandaj Trupi Gjykses e drejton Mbrojtjen e z. Haradinaj që të  
8 hënën, 27 dhjetor të paraqesë deklaratën.

9 Së fundi paraqitja e provave në çështjen e Haradinaj.

10 Ndërsa Trupi Gjykses i uron z. Cadman të shërohet sa më  
11 shpejt, të dy bashkëmbrojtësit e z. Haradinaj priten të jenë  
12 të gatshëm të vazhdojnë me të gjitha fazat vijuese të çështjes  
13 në fillim të janarit edhe nëse z. Cadman mund të mos jetë në  
14 gjendje të jetë i pranishëm.

15 Trupi Gjykses vlerëson se përfaqësimi përmes  
16 bashkëmbrojtësit përbën përfaqësim efektiv dhe mungesa e  
17 bashkëmbrojtësit nuk mund të ketë ndikim në efikasitetin e  
18 procesit gjyqësor.

19 Duke mbajtur parasysh këto, Trupi Gjykses e urdhëron  
20 Mbrojtjen e z. Haradinaj që deri të enjten 6 janar 2022 të  
21 dorëzojë një parashtrim gjithëpërfshirës që do të përmbajë: Së  
22 pari, të gjitha përditësimet apo ndryshimet në listën e  
23 dëshmitarëve që është parashtrimi i tyre fillestar me numër  
24 F461, shtojca 1; gjithashtu listën e përditësuar dhe të  
25 konsoliduar të provave materiale për të cilën dhamë urdhër



1 sot.

2 Trupi Gjykses miraton kërkesën e Haradinajt për shtyrjen  
3 e seancave gjyqësore dhe urdhëron që paraqitja e provave prej  
4 Mbrojtjes së Haradinajt të fillojë të martën, 11 janar, 2022.

5 Trupi Gjykses pret që Mbrojtja e z. Haradinajt të jetë e  
6 gatshme atë kohë për të vazhduar pa ndërprerje me të gjithë  
7 dëshmitarët e saj. Trupi Gjykses do të mbajë seanca të plota  
8 ditore duke filluar nga data 11 deri në 13 janar. Në 17 janar  
9 do të jetë një seancë e plotë.

10 Gjithashtu Trupit Gjykses do të caktojë datën 21, 24 dhe  
11 31 janar si ditë të tjera shtesë për të mbajtur seanca.

12 Këtu përfundon urdhri gojor.

13 Z. Rees, lidhur me parashtimet tuaja për mbylljen e  
14 çështjes, Trupi Gjykses vëren se sipas rregullit 131, çështja  
15 e Mbrojtjes mbyllet kur nuk ka më dëshmitarëve të tjerë për  
16 t'u thirrur apo prova të tjera për t'u paraqitur si pjesë e  
17 provave të Mbrojtjes për çdo të akuzuar. Pra nuk kërkohet që  
18 ta mbyllni tani çështjen duke qenë se Mbrojtja e Haradinajt ka  
19 nevojë ende të paraqesë çështjen e saj.

20 Në varësi të zgjidhjes së kërkesës suaj për pranimin e  
21 disa provave materiale jोगojore, ne e konsiderojmë çështjen  
22 sikur e keni paraqitur përpara nesh. Kur t'i afrohem fundit  
23 të çështjes së z. Haradinajt presim që të mbyllet çështja nga  
24 Mbrojtësi i tij me parashtime me shkrim.

25 Gjykatësi Mettraux ka një pyetje për ju lidhur me

1 dokumentin që kërkon ta paraqisni në mënyrë jogojore.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kam dy pyetje për ju. E  
3 pra ka të bëjë me dokumentin me numër DHG0496 që është  
4 dokumenti për të cilin kërkuat leje për të ndryshuar mocionin  
5 tuaj për dëshmi jogojore.

6 Pyetja ka të bëjë për origjinën e fotografisë të atij  
7 dokumenti. Kam të drejtë të mendoj se është një fotografi e  
8 bërë nga klienti juaj z. Gucati?

9 Z. REES: [Përkthim] Unë mund të marr udhëzime për këtë  
10 dhe t'ju ndihmoj mbase nga fundi, përpara se të përfundojmë.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do të isha mirënjohës.

12 Pyetja e dytë është një çështje sqarimi. Kërkesa juaj për  
13 paraqitjen e provave jogojore përfshin një numër artikujsh të  
14 shtypit dhe raportit të OJQ-ve. Me këtë duhet të kuptojmë që  
15 ju do të mbështeteni në vërtetësinë e brendisë së këtyre  
16 artikujve dhe raporteve?

17 Z. REES: [Përkthim] Ne parashtrojmë se janë nga burime të  
18 besueshme. Pra, agjenci të mirënjohura dhe të respektuara apo  
19 OJQ të tilla për aq sa përmbajtja e tyre është e disponueshme  
20 publikisht siç e kemi paraqitur në mocionin për dëshmi  
21 jogojore, ne parashtrojmë se ato e bëjnë të qartë se personat  
22 siç mund të konkludohet përmenden aty mund të përshkruhen në  
23 mënyrë të arsyeshme si armiq të Kosovës, që ka përbërë një  
24 pjesë të konsiderueshme të pyetjeve që i janë bërë z. Gucati.  
25 Dhe ne themi se këto burime të disponueshme publikisht

1 justifikojnë përshkrimin pavarësisht nga statusi i personave  
2 që përmenden aty edhe nëse janë persona që do jenë dëshmitarë.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, ju kërkonit të  
4 mbështeteni në të vërtetën e këtyre artikujve dhe raporteve?

5 Z. REES: [Përkthim] Po dhe në faktin që janë deklaruar  
6 publikisht. Pra është dhe fakti i të vërtetës së tyre për aq  
7 sa Trupi Gjykses mund tu japë atyre peshë, atyre që  
8 raportohen. Dhe kjo sigurisht është çështje e Trupit Gjykses  
9 lidhur me peshën që mund t'i jepet këtyre burimeve. Por jo  
10 vetëm për përmbajtjen por dhe fakteve të çështjes që  
11 raportohen publikisht.

12 Pra janë dy gjymtyrë të themi, dy aspekte.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po, n.q.s. do të na  
14 referoheni lidhur me fotografinë do tu jemi mirënjohës.

15 Z. REES: [Përkthim] Patjetër, faleminderit.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Trupi Gjykses  
17 do të dëgjojë tani deklaratën hapëse të Mbrojtjes së z.  
18 Haradinaj sipas rregullit 126 dhe 127.

19 Përpara se të fillojmë dua të kujtoj se Trupi Gjykses ka  
20 mbajtur një Konferencë Hapëse në 2 dhjetor, 2021. Në vijim të  
21 parashtrimeve të z. Cadman Trupi Gjykses autorizoi Mbrojtjen e  
22 Haradinajt të bënte deklaratën hapëse pas përfundimit të  
23 paraqitjes së provave.

24 Trupi Gjykses rikujton se në pajtim me paragrafin 1 të  
25 rregullit 126 të Rregullores, deklaratat hyrëse bëhen

1 gojarisht dhe janë vetëm një përmbledhje e përgjithshme e  
2 lëndës së çështjes. Ato janë një përmbledhje e çështjes që do  
3 të thirret. Paraqitja e provave prej Mbrojtjes së Haradinajt do  
4 të fillojë të martën, 11 janar 2022.

5 Z. Worboys, tani keni fjalën.

6 Z. WORBOYS: [Përkthim] Është privilegj që të paraqitem  
7 përpara jush në një nga çështjet e para përpara Dhomave të  
8 Specializuara, një çështje ku juridiksioni dhe përshtatshmëria  
9 e këtij juridiksioni më vë mua një përgjegjësi të rëndë.

10 Sot po lexoj fjalën hapëse të z. Cadman, i cili sikur e  
11 dini nuk ka mundësi të jetë këtu për shkak të arsyeve  
12 shëndetësore.

13 Të nderuar Gjykatës, është e ditur se gjykatat gjykojnë  
14 çështjet por ndonjëherë çështjet e gjykojnë gjykatën dhe kjo  
15 është një rast i tillë.

16 Nga ZPS-ja dëgjuam lidhur me rëndësinë e këtij  
17 institucioni dhe sesi kjo ka të bëjë me mbrojtjen e  
18 individëve. Ne kemi dëgjuar se kjo është një çështje që ka të  
19 bëjë me drejtësinë, me llogaridhënien dhe me shtetin ligjor.

20 ZPS-ja ka të drejtë për secilën prej këtyre pikave.  
21 Megjithatë, çdo referencë ndaj viktimave të konfliktit në  
22 duart e agresorëve serbë është e dukshme duke mos qenë e  
23 pranishme.

24 Qëllimi i këtij institucioni është të sjellë drejtësi për  
25 të gjithë viktimat. N.q.s. dikush meriton drejtësi, atëherë

1 gjithkush meriton drejtësi.

2 Ju mbase mund të mendoni se kjo s'ka lidhje me këto  
3 procedura. Megjithatë, z. Haradinaj besoj se është e lidhur  
4 drejtësisht, plotësisht dhe është thelbësore për Mbrojtjen që  
5 do të paraqitet në emër të tij.

6 I akuzuari, z. Haradinaj, në thelb akuzohet për krime që  
7 përqendrohen në minimin e procesit të drejtësisë. Ai është  
8 akuzuar në një mënyrë apo një tjetër se kërkon ta dëmtojë këtë  
9 institucion, por asnjë nga këto nuk është e vërtetë. Z.  
10 Haradinaj nuk është kundër drejtësisë. Ai është në favor të  
11 saj.

12 Z. Haradinaj ka deklaruar më shumë se një herë se  
13 gjithkush që ka kryer një krim lufte apo krim gjatë një  
14 konflikti të armatosur duhet të procedohet. Ai ka thënë se  
15 askush nuk duhet t'i shpëtojë drejtësisë. Për më tepër, kur z.  
16 Haradinaj u bë nënkryetar i Shoqatës së Veteranëve të Luftës  
17 ai e bëri këtë shumë të qartë. Dhe kjo ishte që personat që  
18 thirren duhet të bashkëpunojnë sepse nuk kishin asgjë për të  
19 fshehur apo për t'u frikësuar.

20 Këto nuk janë aktet e dikujt që përpiqet të pengojë  
21 drejtësinë. Përkundrazi janë veprimet e dikujt që kërkon ta  
22 sigurojë atë.

23 Z. Haradinaj ia ka kushtuar jetën e tij pavarësisë dhe  
24 integritetit fizik të Republikës së Kosovës. Ai është  
25 persekutuar shumë që kur ka qenë i ri derisa është rritur.

1 Është burgosur, është rrahur dhe është nënshtruar dhe tani ai  
2 i nënshtrohet këtyre akuzave.

3 Prokuroria sugjeron se kjo është një çështje e thjeshtë  
4 për tu kuptuar. Por në fakt nuk është.

5 Duke lënë mënjanë hollësitë e kësaj çështjeje për një  
6 sekondë, në qendër të kësaj çështjeje është interesi publik, e  
7 vërteta dhe drejtësia për të gjithë. ZPS-ja në fjalën hapëse  
8 iu referua kësaj çështjeje se ka të bëjë me ndërtimin e  
9 institucioneve, ndërtimin e institucioneve që mund të mbrojnë  
10 ata që kërkojnë ta ndihmojnë atë dhe të sjellë drejtësi për të  
11 gjithë.

12 Por secili prej dokumenteve që thuhet se janë nxjerrë në  
13 këtë çështje dhe që përbëjnë pjesë të kësaj çështjeje kanë  
14 dalë nga Zyra e Prokurorisë Speciale. Të pandehurit nuk i kanë  
15 marrë këto dokumente. Në fakt, në hapjen e tij Prokurori i  
16 Specializuar e konfirmoi për herë të parë se dokumentet ishin  
17 vjedhur dhe e konfirmoi më tej se të pandehurit nuk ishin  
18 përgjegjës për to. Nga kjo rrjedh se ZPS-ja ka pasur masa  
19 sigurie të papërshtatshme dhe kjo është një nga çështjet që  
20 qëndron në themel të saj.

21 Gjithashtu ka dhe çështje të hapura sesi dokumentet  
22 përfunduan në OVL UÇK. Nëse dokumentet janë të vërtetë këto  
23 janë çështje me të cilat Gjykata duhet të përballet; janë  
24 çështje të vështira për t'ju përgjigjur në mënyrë transparente  
25 dhe të drejtë duke pasur parasysh mungesën e dokumentacionit

1 që i është dhënë Mbrojtjes në këtë rast dhe standardet e  
2 dyfishta që janë parë kur vjen puna për shembull, se z.  
3 Berisha është thënë që nuk ka kryer krime porse të akuzuarit  
4 po.

5 Z. Haradinaj është përpjekur të ekspozojë dështimet e  
6 ZPS-së, por ZPS-ja nuk ka, por ZPS-ja ka kërkuar të flasë aty  
7 me të për shqetësimet e tij. Nuk ka kërkuar, përkundrazi është  
8 përpjekur t'ia mbyllë gojën.

9 Një nga karakteristikat e kësaj çështjeje që është  
10 ndryshe nga gjykime të tjera është se nuk përfshin akuza  
11 historike lidhur me konfliktin.

12 ZPS-ja beson se historia nuk ka rëndësi për këtë çështje  
13 fare. Megjithatë nuk është kështu. Historia është me rëndësi  
14 dhe nuk mund të injorohet. Dhe kjo është sepse ajo përbën një  
15 pjesë të madhe të kontekstit të kësaj çështjeje përpara kësaj  
16 Gjykate.

17 Për sa i takon historisë, për të cilën nuk do të flas  
18 duke pasur parasysh udhëzimet e Trupit Gjykses, me të cilat  
19 mbase ne nuk pajtohemi, por jemi të detyruar t'i ndjekim.  
20 Konflikti i njohur në Kosovë zgjati nga 1998 deri në 1999.  
21 Megjithatë, tensionet, shtypja dhe thirrjet për pavarësi dhe  
22 autonomi e paradatojnë atë sikurse dhe masakrat bashkë me të.

23 Ka pasur vuajtje të pafund nga populli i Kosovës në duart  
24 e shtetit serb dhe kjo përfshinte z. Haradinaj dhe familjen e  
25 tij. Po ky shtet serb tani refuzon t'i japë popullit të

1 Kosovës, ta njohë atë ashtu siç e meriton.

2 Kjo është pra, në krye të ndërgjegjësimit jo vetëm të një  
3 numri të zgjedhur individësh, por të të gjithë popullsisë që  
4 kjo Gjykatë përfaqëson dhe institucionit i të cilës ajo është.

5 Një kritikë e rëndësishme dhe ndaj Gjykatës dhe qasjes së  
6 saj është se ajo synon vetëm akuzat e bëra kundër UÇK-së. Kjo  
7 kritikë mbase mund të hidhet poshtë nga disa, por kjo nuk do  
8 të thotë se kritika nuk mund të bëhet. Sikundër z. Smith,  
9 Prokurori i Posaçëm deklaroi në hapjen e tij, kritika të tjera  
10 janë të mirëpritura dhe janë shprehje krejtësisht legjitime të  
11 lirisë së fjalës.

12 Gjatë çështjes së ZPS-së nuk dëgjuam që të ketë ndonjë  
13 hetim për ndonjë krim kryer nga individë që nuk kanë qenë  
14 pjesë e UÇK-së. Rrjedhimisht duket sikur nuk ka hetime në  
15 masakrën e Mejës, ku më shumë se 300 shqiptarë të Kosovës,  
16 shumë prej tyre nën moshën 18 vjeç janë vrarë. Duket se nuk ka  
17 ndonjë hetim në masakrën e Drenicës, një rajon që ka vuajtur  
18 abuzime shumë të mëdha dhe të tmerrshme sikundër Human Rights  
19 Watch e ka vënë në dukje që janë ndoshta përtej fushës së  
20 diskutimit tani.

21 N.q.s. ne i kemi kuptuar drejtë këto hetime, këto masakra  
22 nuk janë subjekt i hetimeve të ZPS-së dhe njeriu mund të pyesë  
23 pse jo. Për më tepër, një pyetje tjetër është se përse  
24 popullsia civile e Kosovës nuk njoftohet lidhur me mos hetimin  
25 e këtyre incidenteve.



1 Kjo nuk ka të bëjë me mosndëshkim. Z. Haradinaj  
2 vazhdimisht ka kërkuar se të gjithë personat duhet të  
3 përballen me drejtësinë. Por për ta bërë këtë në mënyrë të  
4 njëanshme dhe në mënyrë mono-etnike përjetëson teorinë e  
5 pandëshkueshmërisë afatgjatë dhe kjo është një fyerje për  
6 dhjetëra mijëra viktima civile.

7 Tani t'i kthehemi fakteve dhe akuzave konkrete të kësaj  
8 çështjeje. ZPS-ja kërkon që ky Trupi Gjykues ta gjejë z.  
9 Haradinaj fajtor për gjashtë akuza të aktakuzës. Konkretisht  
10 këto që vijojnë: një, pengimin e personave zyrtarë në kryerjen  
11 e detyrave zyrtare përmes kërcënimeve të rënda; dy, pengimin e  
12 personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare përmes  
13 pjesëmarrjes në veprimin e përbashkët të një grupi; tre,  
14 frikësimi gjatë procedurave penale; katër, hakmarrje, katër  
15 [sipas përkthimit] [pesë] shkeljen e fshehtësisë; dhe gjashtë,  
16 shkeljen po ashtu të sekretit të procedurave.

17 Si një vëzhgim paraprak do të them se që nga rrjedhja e  
18 dokumenteve nuk mund të mohohet se janë zhvilluar debate të  
19 forta në Kosovë, duke përfshirë dhe atë që ka ndodhur dhe  
20 çfarë është bërë. Duke përcaktuar rrethanat e çështjes duhet  
21 pyetur: A nuk ka një interes publik për ta mësuar se çfarë po  
22 ndodh? Për shembull, a nuk është në interesin e publikut të  
23 dijë që ZPS-ja po angazhohet me njerëz që janë subjekt i  
24 Interpolit dhe i Red Notice?

25 Z. Haradinaj thotë po. Për më tepër se thotë "po", ai

1 beson se bëhet fjalë për një interes publik të tillë dhe duhet  
2 kuptuar se çfarë ka ndodhur dhe se populli i Kosovës meriton  
3 ta dijë. Edhe z. Berisha një deklaratë, një dëshmitar i ZPS-së  
4 do të pajtohej me të.

5 Është gjithashtu me rëndësi të kujtojmë se z. Haradinaj  
6 nuk e kuptoi këtë mbas 7 shtatorit 2020. Por është diçka që ai  
7 është përpjekur ta adresojë dhe më parë.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë  
9 problem? Ka problem?

10 I AKUZUARI HARADINAJ: Po përkthimin nuk mund ta dëgjoj.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëgjon tani  
12 z. Haradinaj?

13 I AKUZUARI HARADINAJ: Tash po.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

15 Z. WORBOYS: [Përkthim] Faleminderit i nderuar Gjykatës.

16 Pra, po thoja që është e rëndësishme të ngremë tre pika  
17 kryesore.

18 Së pari, ky hetim dhe i gjithë menaxhimi i çështjes nga  
19 ZPS-ja kanë qenë në thelb me defekte. Dhe kur e kam fjalën për  
20 "menaxhimin e çështjes", e kam fjalën për hetimin e ZPS-së dhe  
21 jo për punën e Gjykatës.

22 Thjesht dëshiroj të them që nuk ka pasur asnjë zinxhir  
23 komande efektiv dhe se standardet e hetimeve nga ana e ZPS-së  
24 kanë qenë shumë herë më poshtë sesa ç'pritej prej këtij  
25 institucioni. Kjo është një pikë, e cila njollosë tërësinë e

1 kësaj Prokurorie dhe nuk duhet të zbkurohet.

2 Mbrojtja do të dëshmojë dhe të demonstrojë që Prokuroria  
3 ka qenë në rastin më të mirë neglizhente për hetimet e saj.

4 Së dyti, ndërkohë që z. Haradinaj dhe i bashkëakuzuari  
5 tjetër pretendohet që të kenë nxjerrë tre grupe dokumentesh,  
6 Mbrojtja në vetvete nuk është se ka pasur qasje në këto  
7 dokumente në tërësinë e tyre dhe Trupi Gjykues pretendohet që  
8 të vijojë në interes të drejtësisë, mbështetur vetëm në atë  
9 çfarë thotë ZPS-ja. Ne nuk kemi dëgjuar dëshmitarë ose nuk  
10 kemi pasur asnjë lloj mundësie që të kundërshtojmë dëshmitarë,  
11 të cilët ngrenë pretendime të cilat janë jetike për çështjen e  
12 Prokurorisë.

13 Dhe nuk ka mënyrë që të realizohet drejtësia e hapur dhe  
14 ky është një problem thelbësor, një problem i cili është shumë  
15 i lidhur me ndjekjen penale nga Prokuroria.

16 Së treti, ka një kontradiktë të brendshme në pozicionin e  
17 ZPS-së që sërish lidhet me vetë thelbin e kësaj çështjeje.  
18 Edhe z. Berisha i cili është thirrur nga ZPS-ja si dëshmitar  
19 vërejtji interesin e qartë publik në publikimin e dokumenteve  
20 dhe tha që justifikimi i tij për botim u bërë mbi bazën e  
21 interesit publik.

22 Ai nuk është ndjekur penalisht, nuk është ndjekur nga  
23 Prokuroria për veprimet e tij dhe me të drejtë kështu. Dhe në  
24 këtë kuadër, ne mbështesim komentet e ZPS-së, të cilat  
25 reflektohen në faqen 1507 në transkript dhe në rreshtat

1 përkatës, ku thuhet që nuk është kryer asnjë krim.

2 Megjithatë, n.q.s. z. Berisha nuk ka bërë asgjë gabim,  
3 n.q.s. ai nuk ka kryer asnjë krim, si ka mundësi që z.  
4 Haradinaj këtu që është përpara Gjykatës akuzohet se ka kryer  
5 një krim.

6 Z. Rees në deklaratën e tij hapëse, bëri përmbledhje të  
7 provës së z. Berisha dhe nuk është se dua që t'i referohem  
8 asaj çfarë tha z. Rees lidhur me z. Berisha, por duhet që ta  
9 kujtoj Gjykatën lidhur me këtë deklaratë. Në asnjë fazë, asnjë  
10 media nuk i është kërkuar që të heqë artikuj dhe në asnjë fazë  
11 të caktuar këto media nuk janë bërë objekt i ndonjë kontrolli.  
12 Në fakt ka gazetarë, të cilët me sa dimë neve kanë ende kopje  
13 të këtyre dokumenteve.

14 Si rezultat, pyetja që duhet të bëhet është që pse ne  
15 kemi dy të akuzuar përpara jush sot ndërkohë që ka të tjerë që  
16 kanë bërë të njëjtën gjë dhe nuk pretendohet se kanë bërë  
17 ndonjë krim dhe ndërkohë që situata është kjo.

18 Tani duke kaluar njëra pas tjetrës me pikat e aktakuzës  
19 dhe në mënyrë përmbledhëse pa cenuar argumentet e ardhshme që  
20 mund të ngrihen më lejoni të shtoj si më poshtë.

21 Sa i takon pikës 1 dhe 2, z. Haradinaj nuk ka penguar  
22 asnjë hetim apo punë të ZPS-së. Përkundrazi, fajësimi për  
23 sfidat e ZPS-së duhet të lihet vetëm në derën e ZPS-së. ZPS-ja  
24 ka lejuar që dokumentet të përfundojnë në OVL ose me dashje  
25 ose pa dashje. Për më tepër, Prokurori i Specializuar ka

1 konfirmuar pa pikë dyshimi se as të akuzuarit, asnjë nga të  
2 akuzuarit përpara Gjykatës nuk janë përgjegjës për vjedhjen  
3 ose rrjedhjen e këtyre dokumenteve.

4 Në interesin publik është i dukshëm dhe nuk ka provë sa i  
5 takon pengimit në çështjen në fjalë, pra pengimit të  
6 drejtësisë.

7 Pika 3 e aktakuzës pretendon që z. Haradinaj në vetvete o  
8 ka frikësuar dëshmitarët. Ndërkohë që z. Haradinaj e mohon  
9 këtë gjë dhe përveç kësaj ZPS-ja në vetvete nuk ka ofruar  
10 asnjë provë për të mbështetur këtë pikë të aktakuzës. Për më  
11 tepër Trupi Gjykses nuk ka pasur mundësi që të dëgjojë apo të  
12 analizojë provat e vetë individëve dhe nuk ka dëgjuar asgjë që  
13 ka të bëjë me pretendimin për frikësim.

14 Por në fakt Trupit Gjykses i është kërkuar që të marrë  
15 për të qenë atë çfarë ka thënë ZPS-ja dhe ka prova të  
16 kufizuara nga ZPS-ja dhe sipas mendimit dhe qasjes sonë kjo  
17 nuk mjafton.

18 Në çdo rast kur notat e kontaktit që ka bërë ZPS-ja me  
19 dëshmitarët, pra është e qartë prej këtyre notave që asnjë  
20 prej këtyre individëve nuk ka shprehur ndonjë pretendim të  
21 tillë por në fakt ka thënë që kjo rrjedhje ka rezultuar nga  
22 vetë ZPS-ja.

23 Dhe ndërkohë sa i takon ekzistencës së problemeve mendoj  
24 që këto probleme duhet të lidhen vetëm me ZPS-në.

25 Z. Haradinaj nuk i fshihet faktit që ai është shprehur më

1 përpara lidhur me kritikën e veta por përsëri siç ka thënë dhe  
2 Prokurori i Specializuar vetë, z. Smith kritika është e  
3 pranueshme.

4 Provat, të cilat do të rriten në emër të z. Haradinaj do  
5 të demonstrojnë që nuk janë bërë kërcënime kundër dëshmitarëve  
6 të mbrojtur apo viktimave të çdo krimi e nuk ka pasur asnjë  
7 qëllim që individë të tillë të etiketohen, por në fakt z.  
8 Haradinaj ka theksuar atë çfarë ka ndodhur dhe ka tërhequr  
9 vëmendjen duke vepruar në përputhje me detyrën e tij civile.

10 Ndërkohë, ZPS-ja ka tendencë të përdorë fjalë të tilla si  
11 "gënjeshtar" apo "tradhtar" për të forcuar pretendimet e veta  
12 të pabazuara. Megjithatë, për të kuptuar komentet e z.  
13 Haradinaj në tërësinë e vet, më mirë sesa të përzgjidhen  
14 segmente të caktuara, pra është e rëndësishme që të kuptohen  
15 fjalët e tij në tërësinë e vet dhe për kë janë drejtuar këta  
16 persona. Dhe këta janë persona të cilët janë të kërkuar nga  
17 Interpoli dhe nga autoritetet kosovare.

18 Pika e katërt e aktakuzës pretendon që z. Haradinaj është  
19 përfshirë në hakmarrje. Si në rastin më parë z. Haradinaj nuk  
20 ka qenë i përfshirë në hakmarrje. ZPS-ja pra e ka bërë këtë  
21 akuzë, ndërkohë që z. Haradinaj ka qenë i qartë në pozicionin  
22 e tij.

23 Dhe do të dëgjojmë në veçanti sesi z. Haradinaj e ka  
24 ndryshuar pozicionin e OVL-UÇK-së kur u caktua si  
25 zëvendëskryetar i tij dhe sesi ka siguruar që individët të

1 bashkëpunojnë me DSK-në n.q.s. ata do të kërkoheshin të bënin  
2 një gjë të tillë.

3 Z. Haradinaj mbështet ndjekjen e drejtësisë dhe  
4 llogaridhënien dhe mbështet gjithashtu edhe një proces i cili  
5 është i drejtë dhe transparent. Shkurtimisht, provat që do të  
6 na japë z. Haradinaj në Gjykatë do ta dëshmojnë këtë gjë.

7 Z. Haradinaj nuk është hakmarrë dhe në asnjë fazë ZPS-ja  
8 nuk ka identifikuar persona të cilët e mbështesin këtë akuzë.

9 Pika pesë sugjeron që z. Haradinaj ka shkelur sekretin e  
10 procedurave. Kjo rrëzohet. Ai ka qenë tërësisht i  
11 pandërgjegjshëm dhe i pavetëdijshtëm lidhur me dokumentet në  
12 zotërim të ZPS-së. Ndërkohë që kjo është një çështje  
13 thelbësore.

14 Sa i takon le të themi besimit të përgjithshëm ka një  
15 besim të përgjithshëm dhe këtë do të na e tregojë edhe i  
16 akuzuari që ai vepruar në një mënyrë që është në interes të  
17 publikut.

18 Për më tepër, përpjekjet e z. Haradinaj do të na tregojnë  
19 sesi ai e ka ngritur e këtë çështje me qeverinë, me  
20 institucionet ndërkombëtare dhe me mediat. Ai do të na thotë  
21 sesi e ka ngritur këtë shqetësim me shumë individë dhe  
22 ndërkohë të gjitha shqetësimet e tij nuk u dëgjuan. Si  
23 rezultat, asnjë pranim i pozicionit të tij nuk ka ndodhur.

24 Ndërkohë sa i takon pikës gjashtë, pika gjashtë është e  
25 ngjashme me pikën pesë që kështu unë nuk synoj që ta përsërisë

1 atë. Megjithatë kemi dy faktorë të heshtur [sipas përkthimit],  
2 që duhet të merren parasysh. Së pari dhe siç do të konfirmojë  
3 dhe z. Haradinaj në dëshminë e tij ka shumë individë,  
4 bashkëpunimi i të cilëve me DHSK-në dhe ZPS-në është në sferën  
5 e interesit publik. Dhe disa prej këtyre individëve i kanë  
6 bërë publike dhe punimet e tyre në media dhe vetë.

7 Së dyti, z. Haradinaj ka qenë publikisht i qartë. Ai ka  
8 thënë publikisht dhe ka kërkuar që emrat të mos botohen. Dhe  
9 se çdo nxjerrje informacioni është në interes të publikut.

10 Të nderuar Gjykatës, në përmbyllje më lejoni të them që  
11 ZPS-ja ka prezantuar diçka që ajo konsideron që është një  
12 çështje e thjeshtë por realiteti në fakt nuk është kështu.  
13 Realiteti është i ndryshëm ashtu siç e kemi vënë re nga  
14 provat, të cilat na janë ofruar deri tani.

15 Z. Haradinaj nuk është fajtor për pikat e aktakuzës, por  
16 z. Haradinaj ka qenë i justifikuar në atë çfarë ka bërë dhe  
17 është i justifikuar brenda ligjit.

18 Faleminderit për vëmendjen.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit  
20 z. Worboys.

21 Tani ka ardhur koha të bëjmë përmbledhjen e ditës së  
22 sotme. Do fillojmë me datën 11 janar, ditë e martë, pra 11  
23 janar 2022 në orën 9.30 të mëngjesit, në mënyrë që të mund të  
24 fillojmë me prezantimin në paraqitjen e çështjes e z.  
25 Haradinaj.



1 Faleminderit përkthyesve, faleminderit stafit mbështetës,  
2 faleminderit stafit audio-viziv dhe stafit të sigurisë.  
3 Faleminderit.

4 Ky është fundi i seancës publike. Seanca përfundon këtu.  
5 Faleminderit dhe njëherë.

6 --- Seanca mbyllet në orën 12.35

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25